



I nderuar prind/kujdestar:

Jemi të kënaqur që ju dhe familja juaj jeni anëtarë të komunitetit tonë të larmishëm, ku tani fliten më shumë se njëqind gjuhë të ndryshme. Shkollat Publike të Kontesë Prince William janë angazhuar që t'i japin çdo studenti një *Arsimim të Klasit Botëror*. Meqenëse partneriteti familjar është kritik në atë proces, ne jemi të kënaqur të ofrojmë disa informacione bazë për të ndihmuar çdo prind dhe kujdestar të kuptojë dhe të përfshihet në arsimimin e fëmijës së tyre.

Të gjitha materialet janë siguruar në Anglisht; Sidoqoftë, ne vazhdimisht i përkthejmë dokumentet dhe informacionet kyçe në gjuhët më të kërkuara në zonën tuaj.

Folësit e shumicës të gjuhëve mund të përfitojnë nga informacionet e rëndësishme dhe të përditësuara rregullisht në faqen e Internetit të Shkollave Publike Prince Williams—pwcs.edu—dhe faqet individuale të shkollës. Të gjitha përmbajnë një mjet të mirënjohur Google Translation, i cili ofron përkthim të kufizuar në më shumë se 50 gjuhë. Përkthimet kompjuterike janë shpesh jo të përsosura, por përsëri sigurojnë lidhje me vlerë për informacionet e shkollës. Nëse nuk keni një kompjuter në shtëpi, mund të përdorni një në çfarëdo librari publike.

Ajo që është më e rëndësishmja, Sektori i Shkollës jep mundësi për përkthyesit profesionistë që t'i ndihmojnë folësit e pothuajse çdo gjuhe që të kuptojnë dokumentet që përmbajnë informacione thelbësore rreth të drejtave, përgjegjësisë, pritjeve të studentit dhe prindit dhe çështjet që lidhen me shkollimin dhe dobitë e shërbimet që mund të marrin studentët. Përkthyesit mund të ndihmojnë me konferencat me prindërit rreth këtyre çështjeve për t'u siguruar që të përcillen dhe të kuptohen të dhënat e gjithsecilit. Këto shërbime jepen pa kosto për familjet.

Përdorni cilëndo nga këto metoda për të marrë ndihmën që ju nevojitet.

- Online—shkoni në translations.pwcs.edu.
- Personalisht—vizitoni shkollën e fëmijës tuaj. Vështirë se një folës i gjuhës tuaj do të jetë në dispozicion. Sidoqoftë një punonjës do të përdorë një poster që t'ju ndihmojë.

Sido që të jetë, do t'ju kërkohet që të jepni të mëposhtmet:

- Emrin tuaj dhe emrin e fëmijërisë tuaj;
- Shkollën, nivelin e klasës dhe emrin e mësuesit të fëmijës tuaj;
- Individin (me emër ose profesion) me të cilin doni të flisni, dhe temën e diskutimit; dhe
- Numrin e telefonit dhe orën kur mund të kontaktoheni më së miri.

Nëse fëmija ju sjell një mesazh nga shkolla për një takim; ose nëse dëshironi të programoni një diskutim me një mësues, ose punonjës tjetër shkolle, përdorni metodat më sipër për të kërkuar që një përkthyes t'ju ndihmojë me këto biseda të rëndësishme. Dikush do t'ju kontaktojë sa më shpejt të jetë e mundur.

Përfshirja juaj mund të bëjë një ndryshim pozitiv në arsimimin e fëmijës tuaj, dhe mezi presim t'ju ndihmojnë duke i vënë në dispozicion këto shërbime për ju. Shpresojmë që kjo letër të komunikojë qartë angazhimin e Shkollave Publike të Kontesë Prince William për fëmijën tuaj dhe për ju. Jam i sigurt që edhe ju keni të njëjtën dëshirë si ne për që çdo student të marrë një Arsimit të Klasit Botëror.

Me respekt,



Dr. Steven Walts
Kryeinspektor i Shkollave

*Kur vizitoni pwcs.edu, kërkoni për globin shumëngjyrësh për të gjetur faqet me informacionet e përshkruara në këtë mesazh.

